



## 2019 Përbledhje e shkurtër e FKGK-së

**KCGF: Pjesa e munguar e financimit të NMVM-ve**



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE  
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO  
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Anton Çetta Nr. 5A, 10,000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
+383 (0) 38 225 600 | [www.fondikgk.org](http://www.fondikgk.org)

# PËRMBAJTJE

• PËR PATNERËT TANË	3
Pikat Kryesore të Zhvillimit të Portofolit	3
Pikat Kryesore të Zhvillimeve të Reja	3
• PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMIT TË PORTOFOLIT	4
• PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE TË REJA	6
Dritarja Agro	6
COSME	6
Mjedisi	7
Marrëveshja me MFK	7

## PËR PATNERËT TANË

### Pikat Kryesore të Zhvillimit të Portofolit

Gjatë vitit 2019 FKGK<sup>1</sup> ka vazhduar më tej duke rritur vëllimin e saj të portofolit të garancive. Portofoli i përgjithshëm aktiv arriti në vëllimin prej EUR 43.9 milion i shpërndarë në 3,130 kredi aktive. Vëllimi i përgjithshëm i kredive që janë të garantuara nga FKGK deri në fund të vitit 2019 ishte EUR 156.3 milion i shpërndarë në 4.052 kredi, të cilat do të sigurojnë EUR 169 milion shtesë të rritjes së parashikuar të shitjeve për këta klientë në krahasim me shitjet e tyre fillestare.

Viti i kaluar shënoi një vëllim prej EUR 33.5 milion gjithsej garanci të reja ose rritje prej 25.1% në krahasim me vitin 2018. Investimet në sektorin privat, të mbështetura nga skema e garancive të FKGK-së, mundësuan krijimin e më shumë se 2,803 vendeve të reja të punës vetëm gjatë vitit të kaluar dhe 6.004 vende të reja pune në ekonominë e Kosovës deri më tani. Në të njëjtën kohë, kjo rritje u shoqërua edhe me cilësi të mirë, duke mbyllur vitin me nivelin e KPJ<sup>2</sup>-së prej 1.29%.

### Pikat Kryesore të Zhvillimeve të Reja

Viti u karakterizua gjithashtu nga implementimi i produkteve të reja dhe marrëveshjeve me partnerët tanë. Implementimi i Dritares Agro filloj me nënshkrimin e marrëveshjeve fillimisht me dy banka, duke rritur numrin e përgjithshëm në shtatë banka që janë duke e përdorur tani këtë dritare. Një tjetër e arritur e rëndësishme ishte marrëveshja me EIF<sup>3</sup> për mekanizmin e COSME<sup>4</sup> për të ri-garantuar kredi të FKGK-së për periudhë dy vjeçare, duke filluar nga 16 shtatori. Për më tepër, institucioni filloj të implementojë udhëzimet e KMMS<sup>5</sup>.

**EUR 33.5 milion gjithsej garanci të reja ose rritje prej 25.1% krahasuar me një vit më parë.**

<sup>1</sup> Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

<sup>2</sup> Kreditë jo-performuese

<sup>3</sup> Fondi Investiv Evropian

<sup>4</sup> Konkurueshmëria e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme


<sup>5</sup> Korniza e Mjedisit dhe Menaxhimit Social



## PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMIT TË PORTOFOLIT

Performanca e FKGK-së gjatë viti 2019 u karakterizua me rritje të vazhdueshme dhe cilësi të mirë të portofolit, rritje të kohëzgjatjes dhe shumës mesatare të kredisë dhe kërkesë më të ulët të kolateralit krahasuar me sektorin finansiar në kategorinë e synuar.

Nga EUR 33.5 milion të garantuara, EUR 4.6 milion (ose 13.7%) janë përdorur për të garantuar kredi të sektorit të bujqësisë, përderisa niveli i financimit të sektorit të bujqësisë, siç raportuan bankat në BQK<sup>6</sup>, ishte rreth 4%. Trendi i KJP-ve të portofolit të përgjithshëm është rritur nga 0.35% në 1.29%, që është akoma shumë më poshtë në krahasim me KJP-në e sektorit bankar. Shuma totale e kërkesave të paguara ishte EUR 82,351 për 4 raste.





<sup>6</sup> Banka Qendrore e Kosovës



Deri në fund të vitit 2019 janë garantuar gjithsej 4,052 kredi, të cilat do të sigurojnë rreth EUR 169 milion shtesë të rritjes së parashikuar të shitjeve të këtyre klientëve në krahasim me shitjet e tyre fillestare.

Bazuar në shpërndarjen sektoriale të garancive gjatë vitit 2019, pothuajse 1/3 e tyre janë përdorur për klientët që janë aktiv në aktivitetet tregtare. Vlen të përmendet se sektori i bujqësisë dhe prodhimtarisë kanë shumë më tepër pjesëmarrje në garanci në krahasim me pjesëmarrjen e tyre në sektorin bankar.



Gjatë vitit 2019, kreditë e garantuara për gratë kanë marrë pjesë me 12.5% të totalit të kredive të garantuara, të cilat paraqesin një rritje të lehtë në krahasim me 10% siç ishte në fund të 2018.

Sipas raporteve të bankave, deri në fund të vitit 2019, janë krijuar 6.004 vende të reja pune.





## PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE TË REJA

**Dritarja Agro** – Implementimi i Dritares Agro filloi me nënshkrimin e marrëveshjeve me dy banka të tjera në fillim të vitit, duke arritur numrin e përgjithshëm në shtatë banka që janë duke përdorur aktualisht këtë dritare. Dritarja Agro do të vazhdojë të zhvillojë një portofol që synon të garantojë jo vetëm prodhimtarinë primare bujqësore, por gjithashtu edhe nivelin e sipërm të aktiviteteve të biznesit në zinxhirin e vlerës së bujqësisë, duke përfshirë grumbullimin, përpunimin dhe shitjet/shpërndarjen e këtyre produkteve. Përgjatë kësaj qasje të zinxhirit të vlerës së shtuar brenda sektorit të bujqësisë, ne synojmë të mbulojmë të gjithë sektorin me garanci kreditore të ofruara nga Dritarja Agro.

Përpos vlerës fillestare prej EUR 5 milion që janë përdorur për të rritur potencialin garantues të institucionit për zbatimin e Dritares Agro, KfW do të vazhdojë të rrisë më tej bazën e kapitalit të FKGK-së me një shumë shtesë prej EUR 6.5 milion. Ky kontribut në kapitalin e institucionit do të rrisë aftësinë e institucioneve financiare për të vazhduar më tej financimin e sektorit të bujqësisë, duke vazhduar të garantohet nga FKGK me kushte shumë të favorshme.

Vlen të përmendet se mesi i gushtit shënoi kredinë e 100-të të garantuar në Dritaren Agro. Në total, deri në fund të vitit, ishin paguar më shumë se EUR 9.7 milion kredi bujqësore ose EUR 4.7 milion të portofolit të garantuar të shpërndara në 232 kredi bujqësore.

**COSME** – Më 16 Shtator FKGK përbillyi një marrëveshje të rëndësishme - Marrëveshjen e Garantimit COSME me EIF (pjesë e EIB<sup>7</sup>), për mbështetjen e NMVM-ve. Kjo ngjarje shënoi një tjetër moment të rëndësishëm për FKGK-në pasi marrëveshja me COSME do t'i mundësojë FKGK-së të rrisë portofolin e garancive, gjë që do të rrisë më tej qasjen në financa për NMVM-të në Kosovë, do të rrisë punësimin dhe do të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

<sup>7</sup> Banka Investive Evropiane

Përfitimet e mundësisë së rigarantimit do të ju përcjellen më tej partnerëve të FKGK-së në aspektin e kushteve më të mira të garancisë. Deri më tanj, shtatë banka kanë filluar të përdorin këtë mundësi.

**Mjedisi** – Në bashkëpunim me Bankën Botërore, ne kemi përgatitur KMMS-në. Kjo kornizë na mbështeti më tej për të ngritur PMMS<sup>8</sup>-në institucionale, e cila u miratua nga Bordi i Drejtoreve.

Zbatimi i plotë i PMMS-së do t'i lejojë FKGK të krijojë një imazh të një institucioni miqësor mjedisor dhe social. Duke vepruar kështu, institucioni ynë do të ndihmojë në zvogëlimin e ndikimit negativ mjedisor gjatë aktiviteteve bankare.

**Marrëveshja me MFK<sup>9</sup>** – Më 02 tetor 2019, MFK mbështetur nga Korporata e Sfidave të Mileniumit (MCC), ka nënshkruar një Marrëveshje të Entit Implementues me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), si mekanizëm kryesor në Kosovë që mbështet qasjen në financa për sektorin privat. Kjo marrëveshje rregullon bashkëpunimin në mes të dy organizatave për ngritjen e ekspertizës dhe krijimin e Dritares për Garanci të Kredidhënies për Projekte dhe për Energji të Ripërtëritshme Solare.

Dritarja e garancisë kreditore e mbështetur nga MFK do të fokusohet në tri intervenime kyçë që kanë për qëllim financimin e energjisë së ripërtëritshme solare në Kosovë:

1. Sigurimi i asistencës teknike dhe zhvillimi i kapaciteteve për krijimin e një dritare garantuese për financimin e projekteve të energjisë së ripërtëritshme solare,
2. Lansimi i projektit përvjetues i cili përqëndrohet në kontrollimin e cilësisë dhe zhvillimin e projekteve të energjisë së ripërtëritshme solare të gatshme për financim bankar,
3. Standardizimi i tregut përmes një pakete ku përfshihen trajnime dhe standardizim i projekteve për të ndihmuar bankat partnere të FKGK-së të vlerësojnë faktorët e riskut gjatë vlerësimit të projekteve të energjisë solare.

---

<sup>8</sup> Politikat e Mjedisit dhe Menaxhimit Social

<sup>9</sup> Millennium Foundation Kosovo